



ompania Rajonale e Ujësjellësit "Hidromorava" SH.A  
Regionalna Kompanija za Vodovod "Hidromorava" D.D  
Regional water "Company" "Hidromorava" J.S.C  
Gjilan

Hidromorava Gjilan KOMPANIA RAJONALE  
E UJËSJELLËSIT  
HIDROMORAVA Sh.a.  
No. 481 Data 29.04.2026  
GJILAN

Komisioni i Auditimit i KRU "Hidromorava" Sh.A., Gjilan, në cilësinë e panelit intervistues dhe vlerësues, mbi bazën e vlerësimeve individuale të panelistëve, vlerësimet dhe poentimet mesatar të dalë nga vlerësimet individuale, në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 21 dhe 25 pika (h), të Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, lidhurme dispozitat ligjore të nenit 13 të Ligjit nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/087 për Ndërmarrjet Publike, Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike, pas zhvillimit të procedurave të Konkursit Publik me nr. 183, i publikuar me datë: 03.03.2026, si dhe pas mbajtjes së intervistës me gojë dhe vlerësimet përfundimtar të kandidatëve me datë: 29.04.2026, merr këtë:

## V E N D I M

Për pozitën **Zyrtar i Auditimit të Brendshëm në KRU "Hidromorava" Sh.A.**, sipas Konkursit Publik me nr. 183, i publikuar me datë: 03.03.2026, z. **Betim Jashari**, prej 30 pikëve maksimale është vlerësuar **me 18 pikë**, si kandidati më i suksesshëm për këtë pozitë, bazuar në mesataren e pikëve nga panelistët.

## A r s y e t i m

Komisioni i Auditimit i Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit "Hidromorava" Sh.A. në Gjilan, pas zhvillimit të procedurave të rekrutimit sipas Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, lidhur me Ligjin nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike dhe kërkesave të përgjithshme të Konkursit Publik me nr. 183, i publikuar me datë: 03.03.2026, ka zhvilluar të gjitha procedurat e nevojshme ligjore dhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla Juridike: Kandidatët e pakënaqur me këtë vendim mund të ushtrojnë ankesë në afatin prej tetë (8) ditëve kalendarike nga dita e pranimit të këtij vendimi pranë Komisionit të Auditimit të KRU "Hidromorava" Sh.A.

Ankesat dërgohen në e-mail adresën: [rekrutimi.hidromorava@yahoo.com](mailto:rekrutimi.hidromorava@yahoo.com)

Kryesuesja e Komisionit të Auditimit

( znj. Ferdane Tahiri Sylejmani )

